


The background of the cover is a romantic, painterly illustration. It depicts a woman from behind, wearing a long, flowing white hijab that pools on the ground. She stands in a stone archway, looking out at a serene sunset over a calm sea. The sky is a mix of soft pinks, oranges, and blues, with a few wispy clouds. The sun is a bright, glowing orb on the horizon, its light reflecting on the water. Pink cherry blossom trees frame the archway on both sides, and delicate pink petals are scattered throughout the scene, some floating in the air and others on the ground. The overall mood is peaceful and contemplative.

Jusuf Kastrati

Për ty, motër

*Përgjigje ndaj mëdyshjeve
lidhur me hixhabin*

Titulli

Për ty, motër

Autor

Jusuf Kastrati

Redaktor fetar

Burim Koçinaj

Redaktor gjuhësor

Jeton Koçinaj

Dizajni

Fatlum Zeka

Boton

Instituti Germa

ISBN 978-9951-9279-1-8

© Autori | Ndalohet kopjimi, botimi dhe publikimi, i
plotë e i pjesshëm i librit, në çfarëdo forme qoftë, pa
lejen e autorit!

PËRMBAJTJA

Parathënie	5
Mbulesa, domosdoshmëri e arsyes dhe besimit. 11	
Urtësitë dhe frytet e mbulesës islame	14
Kushtet dhe veçoritë e mbulesës islame	18
Hixhabi është urdhër hyjnor	23
Urdhri i Allahut është i pakundërshtueshëm.....	26
Urdhri i Zotit s'lihet për shkak të gabimeve të njerëzve.....	29
Hixhabi është ibadet, jo dekor.....	32
Hyr në Islam tërësisht!.....	35
Kur fjalët e tyre ta ngushtojnë zemrën	39
Kënaqësia e Allahut mbi çdo gjë tjetër	42
Zgjidh shoqërinë me të cilën Allahu është i kënaqur.....	45
Allahu i do ata që pendohen.....	48
Atij që i frikësohet Allahut, Ai i hap rrugëdalje .	51
S'ka bindje ndaj krijesës duke kundërshtuar Krijuesin.....	54
Mos ki frikë nga njerëzit.....	57
Gjallëria e zemrës qëndron në bindje ndaj Allahut	60
Ruaje Allahun, që Ai të të ruajë ty	63



Bindja ndaj Zotit është nder, jo barrë.....	66
Fillo nga vetja.....	69
Nxito drejt faljes dhe Xhenetit.....	73
Lum të huajt!.....	76
Xheneti nuk fitohet pa flijim	79
Përgatitu për të nesërmen	82
Bindja ndaj Zotit nuk lidhet me martesën.....	86
Para Allahut do të japësh llogari e vetme.....	89
Punën e sotme mos e lër për nesër.....	93
A nuk ka ardhur koha?!.....	96
Hidhe hapin	99
Këshillë përmbyllëse	103



Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Parathënie

Lavdërimet e plota i takojnë vetëm Allahut!
Atë e falënderojmë dhe vetëm prej Tij
kërkojmë ndihmë e falje. Atë që e udhëzon
Allahu, nuk ka kush që e humb, kurse atë që
Allahu e lë në humbje, nuk ka kush që e
udhëzon. Dëshmoj se Allahu është i Vetmi që
meriton të adhurohet dhe se Muhamedi
(ﷺ)¹ është rob dhe i Dërguari i Tij.

Ky libër është për ty, motra ime.

Ndoshta ke menduar shpesh për mbulesën.
Ndoshta e ke dashur, por je ndalur. Ndoshta
je bindur në zemër, por hapi ka mbetur pezull.

¹ Sal-lallahu alejhi ue sel-lem (shqip: paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!).



Ose, ndoshta, thjesht ke pasur pyetje dhe nuk ke gjetur përgjigje të qarta.

Mbulesa është bërë temë diskutimesh, debatesh e paragjykimesh. Flitet shumë për të, por jo gjithmonë me qetësi e drejtësi. Disa e shohin si traditë, të tjerë si kufizim e disa si çështje krejt personale. Por, përpara se të jetë temë shoqërore, ajo është çështje bindjeje ndaj Allahut.

Islami e ka nderuar gruan dhe ia ka dhënë vendin e saj me dinjitet. Nuk e ka vlerësuar për pamjen e jashtme, por për besimin, mendjen dhe karakterin e saj. Brenda këtij udhëzimi, mbulesa zë një vend të qartë. Ajo nuk është dekor e as simbol kulture, por pjesë e bindjes dhe identitetit të besimtares.

Sot jetojmë në një kohë kur gruas i kërkohet vazhdimisht të tërheqë vëmendje e të përshtatet me standarde që ndryshojnë pa pushim. Në këtë realitet, mbulesa shpesh



keqkuptohet, sepse ajo e zhvendos vlerësimin nga dukja te përmbajtja.

Në këtë libër jam përpjekur ta trajtoj mbulesën ashtu siç e trajton Islami: me qartësi dhe argumente nga Kurani e Suneti. Ai synon të heqë mjegullën e dyshimeve dhe ta kthejë çështjen në thelbin e saj, që është bindja ndaj Allahut dhe ruajtja e dinjitetit.

E lusim Allahun që ky libër të bëhet shkak që shumë motra të afrohen më shumë me Zotin e tyre dhe të fitojnë kënaqësinë e Tij përmes bindjes ndaj urdhrave të Tij.



Kreu I

*Vlera, urtësia dhe
rregullat e hixhabit*





Mbulesa, domosdoshmëri e arsyes dhe besimit

Allahu i Madhërishëm e krijoi njeriun në formën më të bukur, por bashkë me këtë bukuri i dhuroi edhe ndjenjën e turpit e prirjen për vetëmbrojtje, gjë që tregon se mbulimi nuk bie ndesh me natyrën njerëzore. Përkundrazi, buron prej saj.

Që në fillimet e njerëzimit, reagimi i parë i njeriut përballë zbulimit të trupit nuk ishte pranimi i zhveshjes, por përpjekja për t'u mbuluar. Kur Ademi (alejhi selam) gaboi, ndjesia që e pushtoi ishte turpi, jo liria. Ai dhe bashkëshortja e tij nxituan të mbulonin veten, duke dëshmuar se zhveshja nuk është gjendje normale për njeriun, por pasojë e shkeljes dhe humbjes së ekuilibrit.

Nëse zhveshja do të ishte gjendje e natyrshme dhe e shëndetshme për njeriun, ajo do të ishte pjesë e jetës në Xhenet. Por, Allahu e



përshkruan Xhenetin si vend ku nuk ka uri, as zhveshje. Kjo tregon qartë se zhveshja lidhet me mungesë, pasiguri dhe vuajtje, ndërsa mbulimi me rehati, dinjitet e qetësi.

Në jetën e kësaj bote, njeriu jeton mes përpjekjes dhe sprovës. Ai ka nevojë për rregulla që e mbrojnë nga egoja dhe nga të tjerët. Mbulesa është një nga këto rregulla mbrojtëse: ajo e mbron gruan nga shndërrimi në objekt vështrimesh e dëshirash.

Argumenti shoqëror e përforcon këtë të vërtetë. Sa më shumë që shoqëritë kanë normalizuar zhveshjen, aq më shumë janë shtuar ngacmimet, presioni mbi pamjen, pasiguria psikologjike dhe komercializimi i trupit. Mbulesa, përkundrazi, e zhvendos vlerësimin nga trupi te personaliteti, nga dukja te sjellja dhe nga forma te përmbajtja.

Edhe historia e qytetërimeve flet qartë. Asnjë shoqëri nuk është njohur si e zhvilluar për



shkak të zhveshjes së saj, porse çdo qytetërim është identifikuar përmes veshjes, rregullit dhe modestisë. Veshja ka qenë gjithmonë shenjë e rendit, e vetëkontrollit dhe e respektit ndaj vetes dhe ndaj tjetrit.

Nga ana fetare, mbulesa është bindje ndaj Allahut dhe shprehje e besimit. Mirëpo, edhe nga ana racionale, ajo është zgjedhje e mençur për ruajtjen e dinjitetit njerëzor dhe ekuilibrit shoqëror. Ajo i vendos kufijtë aty ku janë të domosdoshëm për një jetë të shëndetshme.

Prandaj, mbulesa nuk është simbol prapambeturie e as kufizim i lirisë, siç përpiqen ta paraqesin disa keqdashës, por është shenjë e vetëdijes dhe dinjitetit. Ajo është mburojë për individin dhe themel për një shoqëri më të pastër.



Urtësitë dhe frytet e mbulesës islame

Mbulesa islame ose hixhabi është shprehje e besimit dhe bindjes ndaj Allahut, si dhe mbrojtje e dinjitetit njerëzor. Ajo buron nga urdhri hyjnor dhe nga natyra e pastër e njeriut, duke sjellë fryte të shumta për individin dhe shoqërinë.

Së pari: Bindja ndaj Allahut

Mbulesa është dëshmi e nënshtrimit ndaj urdhrit të Allahut. Muslimania mbulohet për ta kënaqur Zotin e saj, duke treguar se besimi është mbi modën, mbi dëshirat dhe mbi presionin shoqëror. Kjo bindje e forcon imanin dhe e afron zemrën me Allahun.



Së dyti: Ruajtja e nderit dhe dinjitetit

Mbulesa e mbron gruan nga shikimet e pahijshme e nga trajtimi si objekt. Ajo e vendos gruan në pozitën që i takon, duke e vlerësuar për moralin, mendjen dhe karakterin e saj e jo për pamjen e jashtme.

Së treti: Modestia dhe fisnikëria morale

Mbulesa edukon thjeshtësinë dhe largimin nga shfaqja e tepruar. Ajo ndihmon në ndërtimin e një personaliteti të ekuilibruar, ku vlerat morale dhe sjellja e mirë janë mbi dukjen fizike.

Së katërti: Qetësia psikologjike

Mbulesa e çliron gruan nga presioni i vazhdueshëm për t'u dukur dhe për t'u krahasuar me të tjerat. Ajo i jep siguri, qetësi dhe stabilitet të brendshëm.



Së pesti: Mbrojtja e shoqërisë

Mbulesa ndihmon në ruajtjen e marrëdhënieve të shëndetshme ndërmjet burrave dhe grave, duke ulur joshjet dhe devijimet morale, si dhe duke kontribuar në ndërtimin e një shoqërie më të pastër dhe më të respektueshme.

Së gjashti: Edukimi i brezave

Gruaja e mbuluar bëhet shembull i gjallë edukativ për fëmijët dhe rrethin e saj. Ajo përcjell vlera të forta besimi, modestie dhe respekti, duke ndikuar drejtpërdrejt në formimin e një brezi më të shëndoshë shpirtërisht e moralisht.

Së shtati: Forcimi i identitetit islam

Mbulesa është shenjë e qartë e përkatësisë islame dhe e krenarisë për vlerat e fesë. Ajo



forcon identitetin fetar dhe ndihmon në ruajtjen e tij në kohë sfidash.

Në thelb, mbulesa islame është nder, mbrojtje dhe begati. Ajo e ngre lart gruan dhe e ruan dinjitetin e saj, duke e bërë të dobishme për individin, familjen dhe shoqërinë.



Kushtet dhe veçoritë e mbulesës islame

Hixhabi është bindje ndaj Allahut të Madhërishëm dhe ka për qëllim ruajtjen e trupit dhe moralit, prandaj duhet të plotësojë disa kushte thelbësore:

1. Mbulimi i plotë i trupit

Mbulesa duhet ta mbulojë trupin e gruas sipas urdhrit hyjnor, duke mos lënë të zbuluar asgjë përveç fytyrës dhe duarve.² Ajo duhet të jetë e lirshme dhe të mos nxjerrë në pah format e trupit.

2. Pëlhurë mbuluese dhe jo e tejdukshme

Mbulesa duhet të jetë prej pëlhure që e mbulon trupin realisht dhe nuk lejon të shihet lëkura ose hollësitë e trupit.

² Një pjesë e dijetarëve e mbrojnë mendimin se mbulimi i tërë trupit është i detyrueshëm.



3. Të mos jetë tërheqëse për shikimet

Mbulesa nuk duhet të jetë e tillë që të tërheqë vëmendjen përmes ngjyrave, modeleve ose pamjes së saj. Qëllimi i saj është modestia e jo vetëshfaqja. Në këtë frymë, edhe dalja e gruas e parfumuar para burrave të huaj bie ndesh me qëllimin e mbulesës.

4. Të mos jetë zbukurim në vetvete

Mbulesa nuk duhet të shërbejë si stoli a si element zbukurimi. Ajo duhet të jetë e thjeshtë, e matur dhe larg çdo forme që e kthen nga mjet modestie në mjet dekorimi.

5. Ruajtja e identitetit dhe moralit islam

Mbulesa duhet të ruajë identitetin islam dhe të mos imitojë veshje që e zhveshin atë nga kuptimi i saj fetar dhe moral.



6. Pasqyrimi i turpit dhe modestisë

Mbulesa duhet të shprehë turp, vetëpërmbytje dhe hijeshi morale, sepse këto janë thelbi i saj e jo vetëm forma e jashtme.



Kreu II

***Përgjigje ndaj mëdysheve
lidhur me hixhabin***



Hixhabi është urdhër hyjnor

Ajet

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿وَقُلْ لِّلْمُؤْمِنَاتِ يَعْصُونَ مِنِّي وَأَبْصَرِهِنَّ وَأَحْفَظْنَ فُرُوجَهُنَّ وَلَا يُبْدِينَ زِينَتَهُنَّ إِلَّا مَا ظَهَرَ مِنْهَا وَلْيَضْرِبْنَ خُمُرَهُنَّ عَلَىٰ جُيُوبِهِنَّ﴾

“Thuaju besimtareve të ulin shikimin e tyre, të ruajnë nderin e tyre dhe të mos e zbulojnë bukurinë e tyre përveç asaj që është e dukshme. Le t'i lëshojnë mbulesat e tyre (të kokës) mbi kraharorët e tyre...” (Kurani, 24:31)

Hadith

Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të) thoshte:

*“Allahu i mëshiroftë gratë e para muhaxhire! Kur Allahu e zbriti ajetin: **“Le t'i lëshojnë mbulesat e tyre (të kokës) mbi kraharorët e tyre”,** ato i grisën rrobat e tyre dhe u mbuluan me to.”*³

³ Buhariu (4758, *mual-lek*), Bejhekiu (13637), Ebu Davudi (4102) dhe Nesaiu (11299).



Mëdyshje

Mbulesa është traditë, jo detyrë fetare (!)

Kjo është një mëdyshje që e dëgjojmë herë pas here, gjë që është krejt e paqëndrueshme përballë argumenteve të qarta që gjenden në Kuran dhe në Sunet.

Mbulesa është urdhër i drejtpërdrejtë i Krijuesit i shpallur në Librin e Tij dhe i shpjeguar nga i Dërguari i Tij, Muhamedi, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!

Muslimania e vërtetë i bindet Zotit të saj, ashtu siç iu bindën gratë e para muslimane, të cilat, për shkak të besimit të tyre të palëkundshëm, sapo e dëgjuan urdhrin e Allahut, u mbuluan menjëherë, pa pritur as të ktheheshin në shtëpitë e tyre.



Këshillë

Motra ime e nderuar, mos lejo të biesh pre e atyre që përpiqen ta ndryshojnë Fenë e Zotit dhe ta zbrazin atë nga përmbajtja e saj, për t'i larguar besimtarët nga udhëzimi i vërtetë. Ata nuk duan që ne t'u nënshtrohemi urdhrave të Krijuesit e të jetojmë me nder, sepse dëlirësia bie ndesh me dëshirat e tyre të shfrenuara.

Prandaj, zgjidh bindjen ndaj urdhrave të Zotit dhe kënaqësinë e Tij!

Bëhu robëreshë e Allahut e mos u bëj skllave e dëshirave të askujt, sepse nuk ka nder më të madh për një grua besimtare sesa ta vendosë bindjen ndaj Allahut para çdo gjëje tjetër.



Urdhri i Allahut është i pakundërshtueshëm

Ajet

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿وَمَا كَانَ لِمُؤْمِنٍ وَلَا مُؤْمِنَةٍ إِذَا قَضَى اللَّهُ وَرَسُولُهُ أَمْرًا أَنْ يَكُونَ لَهُمُ الْخِيَرَةُ مِنْ أَمْرِهِمْ ۗ وَمَنْ يَعْصِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ فَقَدْ ضَلَّ ضَلَالًا مُبِينًا﴾

“Nuk i takon asnjë besimtari e besimtareje që, kur Allahu dhe i Dërguari i Tij gjykojnë për ndonjë çështje, ata të kenë të drejtë zgjedhjeje në çështjen e tyre. Kushdo që nuk i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, ka rënë në një humbje të qartë.” (Kurani, 33:36)

Hadith

I Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë:

“Nuk ka besuar plotësisht ai që nuk i ka dëshirat në përputhje me atë që kam ardhur.”⁴

⁴ Ibn Ebi Asimi (Es-Sunneh, nr. 15), Hatibi (Tarihu Bagdad, 4/368) dhe Bejhakiu (El-Med’hal ila es-Sunen el-Kubra, f. 209).



Mëdyshje

Mbulesa është vendim personal (!)

Kjo shprehje shpesh përdoret si një barrikadë për t'i mbyllur derën këshillës, por le t'i ndajmë gjërat: është e vërtetë se llogaria para Allahut është individuale dhe askush nuk mund t'i bartë gjynahet e tjetrit. Megjithatë, kjo fjalë bëhet e rrezikshme kur përdoret për të relativizuar detyrimin hyjnor.

Mbulesa nuk është një zgjedhje stili që e përcakton njeriu sipas dëshirës, por një urdhër i prerë që e ka përcaktuar Krijuesi. Ne nuk mund të zgjedhim se cilat pjesë të fesë na pëlqejnë e cilat jo, sepse besimi nuk është një meny, ku ne marrim vetëm atë që na e ka ënda. Të thuash: "Është vendim personal" për një urdhër të prerë të Zotit, është sikur të pretendosh se njeriu ka të drejtë të vendosë nëse ligji i Krijuesit vlen për të ose jo.



Këshillë

Motra ime e nderuar, liria e vërtetë nuk arrihet duke ndjekur çdo dëshirë që na vjen në mendje, por duke pasur forcën për t'iu bindur Atij që na krijoi. Shpesh ne e quajmë "vendim personal" atë që në të vërtetë është frikë nga gjykimi i njerëzve ose dëshirë për t'u dukur bukur para të tjerëve.

Dije se pas çdo urdhri të Allahut fshihet një urtësi e pafundme, edhe nëse mendja jonë e kufizuar nuk e rrok dot menjëherë. Ai që krijoi universin, e di më së miri se çfarë e mbron nderin tënd dhe çfarë i jep qetësi shpirtit tënd. Mos e kthe veten në skllave të opinionëve që ndryshojnë çdo ditë, por gjeje lirinë tënde te bindja ndaj Allahut, ligjet e të Cilit nuk ndryshojnë. Rregulloje lidhjen me Allahun, që jeta jote të marrë kuptimin e duhur!



Urdhri i Zotit s'lihet për shkak të gabimeve të njerëzve

Ajet

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا قُوا أَنْفُسَكُمْ وَأَهْلِيكُمْ نَارًا وَقُودُهَا النَّاسُ وَالْحِجَارَةُ﴾

“O ju që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga një Zjarr, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët!” (Kurani, 66:6)

Hadith

I Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë:

“Nuk do të lëvizin këmbët e robit (në Ditën e Gjykimit) derisa të pyetet për katër gjëra: për jetën e tij – si e ka kaluar; për dijen e tij – çfarë ka vepruar me të; për pasurinë e tij – prej nga e ka fituar e ku e ka shpenzuar; dhe për trupin e tij – në çfarë e ka harxhuar.”⁵

⁵ Tirmidhiu (2417), Darimiu (537) dhe Ebu Jala (7434). Albani e ka vlerësuar si sahih në “Sahihul Xhami’i” (7300).



Mëdyshje

Si të mbulohem, kur ka gra të mbuluara që nuk i bëjnë nder mbulesës?!

Kjo mëdyshje zakonisht lind nga kërkimi i një preteksti për ta shtyrë bindjen. Disa vajza mund të thonë: “Ka gra të mbuluara që me sjelljen e tyre nuk i bëjnë nder mbulesës.” Por, pyetja më e sinqertë është: pse t’i bëj gabimet e disa grave të mbuluara pretekste për ta lënë mbulesën e të mos i bëj gabimet e shumë grave të pambuluara arsye për të thënë: “Nuk dua të mbetem pa mbulesë”?

Gabimi i njerëzve nuk e arsyeton lënien e urdhrit të Allahut. Mangësitë e disa të mbuluarave nuk ia ulin aspak vlerën mbulesës, ashtu si keqzbatimi i një adhurimi nga disa njerëz nuk e zhbën vlerën dhe detyrueshmërinë e atij adhurimi. Mbulesa është përgjegjësi personale para Allahut, jo reagim ndaj sjelljes së të tjerëve.



Këshillë

Motra ime, mos e zhvendos përgjegjësinë nga vetja te të tjerët. Ti nuk mbulohesh për të treguar se je më e mirë se dikush, por për t'iu bindur Allahut, edhe kur të tjerët dështojnë. Në Ditën e Gjykimit gjithsecili do të qëndrojë vetëm para Allahut, pa justifikime e pa krahasime.

Mos lejo që gabimet e njerëzve të bëhen shkak për largimin tënd nga e vërteta! Nëse dikush e shkel mbulesën me sjellje, është përgjegjësi e saj. Por, nëse ti nuk e vë mbulesën për shkak të tyre, atëherë do të japësh llogari për këtë, në Ditën e Gjykimit.

Mbulohu për Allahun, ruaje trupin që e ke amanet e mos shiko çfarë bëjnë të tjerët, se ti do të merresh në llogari për veten tënde!



Hixhabi është ibadet, jo dekor

Ajet

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿وَاللَّهُ يُرِيدُ أَنْ يَتُوبَ عَلَيْكُمْ وَيُرِيدُ الَّذِينَ يَتَّبِعُونَ الشَّهَوَاتِ أَنْ تَمِيلُوا مَيْلًا عَظِيمًا﴾

“Allahu dëshiron t’jua pranojë pendimin, ndërsa ata që ndjekin epshet dëshirojnë që ju të shmangeni fort (nga rruga e drejtë).”
(Kurani, 4:27)

Hadith

I Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë:

“Dy lloje të banorëve të Zjarrit nuk kam arritur t’i shoh: persona që në duar mbajnë kamxhikë si bishta lopësh, me të cilët i rrahin njerëzit, si dhe gra të veshura, por në të vërtetë të zhveshura, të përdredhura, që shkaktojnë përdredhjen e zemrave (të burrave drejt tyre), kokat e të cilave u ngjasojnë gungave të deveve që lakohen nga njëra anë. Ato s’do të hyjnë në



*Xhenet e as do ta nuhasin aromën e tij, edhe pse aroma e tij nuhatet prej një distance të largët kaq e kaq.*⁶

Mëdyshje

Dua të mbulohem, por pa lënë anash modën (!)

Nuk mund t'u shërbesh njëkohësisht dy kërkesave të kundërta: modestisë që kërkon Allahu dhe rënies në sy që e kërkon moda. Kur hixhabi ngushtohet, shkurtohet ose kthehet në mjet për të tërhequr vëmendjen, ai e humbet shpirtin e tij dhe mbetet thjesht një copë pëlhure.

“E veshur, por e zhveshur” është gjendja e asaj mbulese që mbulon trupin, por nuk e fsheh dëshirën për të qenë e admiruar nga të tjerët. Nëse qëllimi yt është t'u pëlqesh njerëzve, do të mbetesh gjithmonë skllave e trendeve. E, nëse qëllimi yt është ta kënaqësh Allahun, atëherë lirinë do ta gjesh te thjeshtësia.

⁶ Muslimi (125 / 2128 / 5582).



Këshillë

Motra ime e nderuar, hixhabi nuk është stil i ri veshjeje, por një akt i pastër nënshtrimi ndaj Krijuesit. Mos e kthe mbulesën në mjet për të tërhequr shikimet, sepse ajo është shpallur pikërisht për t'i mbrojtur ato. Ti nuk mbulohesh për të treguar se sa bukur di të dukesh nën petkun e fesë, por për të dëshmuar se sa shumë e çmon urdhrin e Allahut mbi çdo pëlqim njerëzor.

Bota përpiqet vazhdimisht që njeriun ta shmangë fort nga rruga e drejtë, duke e zbratur adhurimin nga kuptimi i tij dhe duke e shndërruar mbulesën në dekor kalimtar. Mos e shkëmbe aromën e Xhenetit me një pëlqim a kompliment që vjen nga harami! Bukuria jote është një amanet i çmuar, andaj mos e kthe atë në shkak tundimi për zemrat e të tjerëve!



Hyr në Islam tërësisht

Ajet

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا ادْخُلُوا فِي السِّلْمِ كَافَّةً وَلَا تَتَّبِعُوا خُطُوَاتِ الشَّيْطَانِ إِنَّهُ لَكُمْ عَدُوٌّ مُبِينٌ﴾

“O besimtarë! Hyni në Islam tërësisht e mos ndiqni gjurmët e shejtanit, ngaqë ai është armik juaji i hapur.” (Kurani, 2:208)

Hadith

I Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë:

“Allahu i Lartësuar ka caktuar për ju detyra, andaj mos i shpërfillni, ka vënë kufij, ndaj mos i tejkaloni, ka ndaluar disa gjëra, kështu që mos i shkelni, si dhe ka heshtur kundrejt disa gjërave në shenjë mëshire për ju e jo për shkak të harresës, prandaj mos i gjurmoni.”⁷

⁷ Hadith hasen. E shënon Darakutniu në sunenin e tij (4/184) dhe disa të tjerë.



Mëdyshje

Më mjafton namazi, s'është patjetër të mbulohem (!)

Kjo mëdyshje buron nga një kurth i hollë i shejtanit, i cili përpiket të na bindë se mjafton të zbatojmë një pjesë të fesë për të qenë në rregull me Krijuesin. Mirëpo, besimi nuk është një listë dëshirash, ku ne zgjedhim çfarë na pëlqen dhe lëmë pas atë që na duket sfiduese. Të thuash: "Më mjafton namazi", ndërkohë që anashkalon mbulesën, është sikur të pranosh një ftesë, por të refuzosh të hysh brenda. Namazi është lidhja jote shpirtërore, por mbulesa është dëshmia jote e jashtme e mbrojtja e kësaj lidhjeje. Të dyja janë pjesë e të njëjtit Islam që na kërkon t'i dorëzohemi Allahut me tërë qenien tonë.



Këshillë

Motra ime e nderuar, kur Allahu na thotë: *"Hyni në Islam tërësisht"*, Ai na tregon se lumturia dhe qetësia e plotë gjenden vetëm atëherë kur nuk mbajmë asgjë rezervë para Tij. Namazi që ti fal është drita e shpirtit tënd, por mos lejo që kjo dritë të kufizohet vetëm brenda mureve të shtëpisë sate. Le të jetë namazi forca që të jep guximin për ta kurorëzuar besimin tënd edhe me mbulesë.

Mos e harro strategjinë e shejtanit: ai nuk të thotë menjëherë: "Lëre fenë", por të nxit të bësh hapa të vegjël drejt shpërfilljes. Ai fillon duke të thënë: "Të mjafton namazi", me qëllim që nesër të të thotë: "Mjafton ta kesh zemrën të mirë", derisa dalëngadalë të të largojë nga çdo vepër që të afron me Zotin.

Mbulesa nuk është një shtojcë që mund ta lëmë pas, por është pjesë e pandashme e asaj që ti je: një robëreshë e Allahut që i bindet Atij në çdo kohë dhe vend. Duke u mbuluar, ti



dëshmon se nuk i bindesh Allahut me gjysmë zemre, por me tërë qenien tënde. Dorëzoju urdhrit të Tij plotësisht dhe do të shohësh se si namazi yt do të marrë një tjetër shije, e jeta jote një tjetër kuptim.



Kur fjalët e tyre ta ngushtojnë zemrën

Ajet

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿وَلَقَدْ نَعْلَمُ أَنَّكَ يَضِيقُ صَدْرُكَ بِمَا يَقُولُونَ ﴿٩٧﴾ فَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ وَكُن مِّنَ السَّاجِدِينَ ﴿٩٨﴾ وَاعْبُدْ رَبَّكَ حَتَّىٰ يَأْتِيَكَ الْيَقِينُ ﴿٩٩﴾﴾

“Ne e dimë mirë se ty të ngushtohet gjoksi për shkak të asaj që thonë ata, por ti lartësoje Zotin tënd me lavdërim e ji prej atyre që bëjnë sexhde dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!” (Kurani, 15:97-99)

Hadith

I Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë:

“Besimtari i cili përzihet me njerëz dhe bën durim ndaj lëndimeve të tyre, është më i mirë se besimtari i cili nuk përzihet me njerëz dhe nuk bën durim ndaj lëndimeve të tyre.”⁸

⁸ Ibn Maxhe (4032), Ahmedi (5022) dhe Buhariu në "El-Edeb el-Mufrad" (388).



Mëdyshje

Nëse mbulohem, do të thonë se jam e prapambetur, e shtypur etj. (!)

Frika nga paragjykimet është reale. Është e natyrshme të shqetësohesh nga fjalët që mund të thuhën: “e prapambetur”, “e shtypur”, “ekstremiste”, ose “e huaj” në vendin tënd. Por, këto etiketa nuk flasin për ty; ato flasin për mënyrën se si të tjerët e shohin botën, andaj mos ua var veshin. Hixhabi yt i sfidon bindjet e tyre dhe, për këtë arsye, fjalët e tyre bëhen të vrazhda.

Të të ngushtohet gjoksi në raste të tilla është njerëzore. Edhe Profetit (ﷺ) i ngushtohej gjoksi nga fjalët e njerëzve. Por, Allahu nuk i tha të tërhiqej ose të fshihej, por ta forconte lidhjen me Zotin e tij, me adhurim, me sexhde dhe me qëndrueshmëri.



Këshillë

Motra ime e nderuar, asnjë etiketë nuk e përcakton vlerën tënde, përveç nëse ti vetë ia jep atë fuqi. Kur të quajnë “e shtypur”, kujto se ti ke zgjedhur me vetëdije t’i bindesh Allahut, jo presionit të njerëzve. Kur të quajnë “ekstremiste”, kujto se në një botë që largohet nga e vërteta, çdo qëndrim i drejtë duket i tepruar.

Mos u pikëllo dhe mos e ul kokën! Përballu me fjalët e tyre me durim, qetësi e moral të lartë! Le të jetë hixhabi yt pjesë e personalitetit tënd të fortë, jo pengesë për arritjet e tua. Kur fjalët bëhen të rënda, kërko strehim duke rënë në sexhde para të Gjithëfuqishmit dhe qëndro e palëkundur në fenë tënde!

Mbaje në mend: është shumë më e lehtë të durosh disa fjalë në këtë botë sesa të përballesh me pendim kur të dalësh para Allahut! Ti je e nderuar, e mbrojtur dhe e lirë në bindjen tënde. Pikërisht kjo i shqetëson ata që lirinë e shohin vetëm sipërfaqësisht.



Kënaqësia e Allahut mbi çdo gjë tjetër

Ajet

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿وَإِنْ تُطِيعُوا أَكْثَرَ مَنْ فِي الْأَرْضِ لِيُضِلُّوكَ عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ إِنَّ يَتَّبِعُونَ إِلَّا الظَّنَّ
وَإِنْ هُمْ إِلَّا يَخْرُصُونَ﴾

“Nëse u bindesh shumicës së atyre që janë në Tokë, do të të shmangin nga rruga e Allahut. Ata ndjekin vetëm hamendjet dhe vetëm gënjejnë.” (Kurani, 6:116)

Hadith

I Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë:

*“Kush kërkon kënaqësinë e Allahut duke shkaktuar zemërimin e njerëzve, atij do t’i mjaftojë Allahu dhe do ta mbrojë nga njerëzit. Ndërsa atë që kërkon kënaqësinë e njerëzve duke shkaktuar zemërimin e Allahut, Allahu do ta lërë në dorë të njerëzve.”*⁹

⁹ Tirmidhiu (2414), Abd ibn Humejdi (1522) dhe Ibn Hibbani (276).



Mëdyshje

Nëse mbulohem, do të dukem ndryshe nga shoqëria (!)

Kjo frikë buron nga dëshira e natyrshme e njeriut për t'u ndier i pranuar, por duhet të kujtojmë se e vërteta nuk matet me numrin e njerëzve që e ndjekin atë. Shumica nuk është gjithmonë kriter i së drejtës. Nëse shoqëria largohet nga rruga e Krijuesit, të dukesh ndryshe duke iu bindur Allahut nuk është dobësi, por është guxim, integritet e fisnikëri. Të jesh ndryshe për hir të Zotit është një nder që nuk mund ta ofrojë asnjë modë e trend kalimtar.

Këshillë

Motër e nderuar, mos e kërko vlerën tënde në sytë e njerëzve, sepse zemrat e tyre janë në Dorën e Allahut! Nëse ti e kënaq Allahun me mbulesën tënde, Ai do të hedhë dashuri dhe respekt për ty në zemrat e njerëzve që vlejnë, edhe nëse në fillim të gjykojnë. Mos u bëj si



gjethe që e degdis era ngado që fryn, por bëhu si pema me rrënjë të thella në besim!

Hudhejfe ibnul Jemani (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thoshte: *“Mos u bëni ndjekës të verbër, duke thënë: “Nëse njerëzit bëjnë mirë, bëjmë edhe ne mirë, e, nëse ata bëjnë padrejtësi, bëjmë edhe ne padrejtësi.” Përkundrazi, edukojeni veten që, kur njerëzit bëjnë mirë, të bëni edhe ju mirë, e, kur ata bëjnë keq, të mos i pasoni në të keqe!”*¹⁰

Dije se më mirë është të jesh e huaj në sytë e njerëzve, por e dashur tek Allahu, sesa të jesh e duartrokitur nga bota, por e braktisur nga mëshira e Zotit!

¹⁰ Albani, Hidajetul-Ruvah (5057).



Zgjidh shoqërinë me të cilën Allahu është i kënaqur

Ajet

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿وَيَوْمَ يَعِضُ الظَّالِمُ عَلَى يَدَيْهِ يَقُولُ يَلْبِئْتَنِي أَخَذْتُ مَعَ الرَّسُولِ سَبِيلًا ﴿٧٧﴾
يُؤَيِّلَنِي لَيْتَنِي لَمْ أَخُذْ فُلَانًا خَلِيلًا ﴿٧٨﴾ لَقَدْ أَضَلَّنِي عَنِ الذِّكْرِ بَعْدَ إِذْ جَاءَنِي
وَكَانَ الشَّيْطَانُ لِلْإِنْسَانِ خَذُولًا ﴿٧٩﴾﴾

“Atë Ditë, keqbërësi do të kafshojë duart e veta, duke thënë: "Ah, i mjeri unë! Sikur të kisha ndjekur udhën e drejtë bashkë me të Dërguarin! Ah, i mjeri unë! Sikur të mos e kisha marrë filanin për mik të ngushtë! Ai më largoi nga Këshilla (Kurani) pasi më erdhi." Shejtani gjithnjë e tradhton njeriun.”
(Kurani, 25:27-29)



Hadith

I Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë:

“Njeriu është në fenë e mikut të vet, prandaj le të shikojë kë po merr për mik.”¹¹

Mëdyshje

Nëse mbulothem, shoqet e mia do të largohen nga unë (!)

Kjo frikë është shpesh një pengesë që na e vendos vetvetja ose ndikimi i jashtëm, por duhet të pyesim veten: “Çfarë shoqërie na qenka ajo që na do vetëm kur ne u përshtatemi tekave të tyre dhe na braktis sapo vendosim t’i bindemi Krijuesit tonë?” Një shoqëri që të kushtëzon miqësinë me largimin nga feja, nuk është shoqëri e vërtetë, por është një barrë që të mban mbrapa. Nëse disa njerëz largohen sepse ti zgjodhe rrugën e Zotit, dije se Allahu do t’i zëvendësojë ata me miq të

¹¹ Ebu Davudi (4833), Tirmidhiu (2378) dhe Ahmedi (8398).



sinqertë, që të duan për atë që je dhe që të ndihmojnë të bëhesh edhe më e mirë.

Këshillë

Motra ime e nderuar, miqësia e vërtetë është ajo që vazhdon edhe në Xhenet, e jo ajo që përfundon te pragu i varrit. Mos e flijo lumturinë e përhershme për hir të dikujt që nuk do të mund të të bëjë dobi Ditën kur secili do të thotë: "Ah, i mjeri unë!"

Zgjidhi shoqet që, kur i sheh, ta kujtojnë Allahun, që të japin kurajë kur ligështohesh dhe që gëzohen për sukseset e tua në rrugën drejt Zotit tënd. Mbulesa jote do të jetë si një "filtër" i natyrshëm: ajo do t'i mbajë larg ata që duan vetëm pamjen tënde të jashtme dhe do t'i afrojnë ata që e vlerësojnë imanin tënd. Mbaje në mend se më mirë është të ecësh e vetme drejt kënaqësisë së Zotit sesa të ecësh me turma drejt humbjes!



Allahu i do ata që pendohen

Ajet

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿قُلْ يٰعِبَادِيَ الَّذِينَ أَسْرَفُوا عَلَىٰ أَنْفُسِهِمْ لَا تَقْنَطُوا مِن رَّحْمَةِ اللَّهِ إِنَّ اللَّهَ يَغْفِرُ الذُّنُوبَ جَمِيعًا إِنَّهُ هُوَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ﴾

“Thuaj: "O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar veten me shumë gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut, se, me të vërtetë, Allahu i fal të gjitha gjynahet. Njëmend, Ai është Falësi i Madh, Mëshirëploti.” (Kurani, 39:53)

Hadith

I Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë:

*“Çdo bir i Ademit është gabimtar, por gabimtarët më të mirë janë ata që pendohen gjithnjë.”*¹²

¹² Tirmidhiu (2499), Ahmedi (13049) dhe Ibn Maxhe (4251).



Mëdyshje

Jam gjynahqare, s'jam e denjë për mbulesë (!)

Pa më thuaj, motër, në vend se t'i lëmë detyrimet fetare për shkak të gjynaheve, a nuk është më e udhës t'i kthehemi Allahut, duke zbatuar urdhrat e Tij dhe duke hequr dorë nga gjynahet, të cilat vetëm na e nxijnë zemrën, na e vështirësojnë jetën dhe na largojnë nga mëshira e Allahut?!

Pra, detyrimet nuk lihen për shkak të gjynaheve, përkundrazi, ato janë rruga e shpëtimit prej tyre.

Këshillë

Motër e nderuar, për të zbatuar urdhrat e Allahut, nuk kërkohet nga ne të jemi pa gjynahe, sepse, në fund të fundit, nuk ka njeri pa gjynahe. Prandaj, mbulohu dhe përpiqu të largohesh nga gjynahet, sidomos nga të mëdhatë, se, kur zbaton detyrimet fetare,



Allahu të ndihmon për t'u larguar nga gjynahet dhe të jep një lumturi shpirtërore, të cilën nuk dëshiron ta ndërrosh me asgjë në këtë botë.

Prandaj, vëre mbulesën ashtu si i ka hije muslimanes, pendohu tek Allahu dhe mos e shtyj kthimin, si dhe kujto gjithnjë se:

﴿إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ التَّوَّابِينَ وَيُحِبُّ الْمُتَطَهِّرِينَ﴾

“Allahu i do ata që pendohen dhe i do ata që pastrohen.” (Kurani, 2:222)



Atij që i frikësohet Allahut, Ai i hap rrugëdalje

Ajet

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿وَمَنْ يَتَّقِ اللَّهَ يَجْعَلْ لَهُ مَخْرَجًا ۖ وَيَرْزُقْهُ مِنْ حَيْثُ لَا يَحْتَسِبُ وَمَنْ يَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ فَهُوَ حَسْبُهُ﴾

“... Atij që i frikësohet Allahut, Ai i hap rrugëdalje dhe e furnizon prej nga nuk e pret. Atij që i mbështetet Allahut, Ai i mjafton...” (Kurani, 65:2-3)

Hadith

I Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë:

“Sa herë që njeriu heq dorë prej diçkaje për hir të Allahut, Allahu ia zëvendëson atë me diçka më të mirë.”¹³

¹³ Ahmedi (20739), Ebu Nuajmi (7315) dhe Bejhakiu (5364).



Mëdyshje

Nëse mbulohem, mund të më përjashtojnë nga shkolla (!)

Kjo frikë është shpesh një pengesë që na e paraqet shejtani për të na zmbrapsur nga bindja ndaj Krijuesit, duke na bërë të mendojmë se do të na mbyllen rrugët e dijes. Por, duhet të kujtojmë se Ai që na ka urdhëruar të kërkojmë diturinë, është pikërisht Ai që na ka urdhëruar edhe të mbulohemi. Nuk duhet të besojmë se zbatimi i një urdhri të Zotit do të bëhet shkak për dështimin tonë. Përkundrazi, suksesi i vërtetë në mësim dhe në jetë vjen vetëm me ndihmën dhe bekimin e Allahut.

Këshillë

Motra ime e nderuar, asnjë diplomë nuk ka vlerë nëse ajo arrihet duke zemëruar Atë që të ka dhënë mendjen dhe mundësinë për të mësuar. Kur zgjedh bindjen ndaj Allahut, ti ke zgjedhur Mbikëqyrësin më të Fuqishëm në



rrugëtimin tënd drejt diturisë. Dije se Allahu nuk e lë kurrë në baltë atë që sakrifikon diçka për hir të Tij.

Edhe nëse do të ndodhte të të përjashtonin, gjë që në realitet është larg mendsh, s'ke pse dëshpërohesh, se, kur të mbyllet një derë për shkak se ti zgjedh kënaqësinë e Allahut, Ai t'i hap dhjetë porta të tjera më të mira. Nëse një mjedis shkollor nuk e pranon identitetin tënd si besimtare, atëherë ajo shkollë nuk është vendi ku ti do të mund të rriteshe e qetë dhe e suksesshme. Beso fort se Allahu mund të të drejtojë drejt një shkolle tjetër, me kushte më të mira dhe me njerëz që do ta respektojnë vlerën tënde. Mbaje në mend se kush është me Allahun, i ka të gjitha rrugët të hapura, sepse çdo sukses është vetëm në Dorën e Allahut!



S'ka bindje ndaj krijesës duke kundërshtuar Krijuesin

Ajet

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿وَإِنْ جَاهِدَاكَ عَلَىٰ أَنْ تُشْرِكَ بِي مَا لَيْسَ لَكَ بِهِ عِلْمٌ فَلَا تُطِعْهُمَا ۖ
وَصَاحِبُهُمَا فِي الدُّنْيَا مَعْرُوفٌ ۚ وَأَتَّبِعْ سَبِيلَ مَنْ أَنَابَ إِلَيَّ ثُمَّ إِلَيَّ مَرْجِعُكُمْ
فَأُنَبِّئُكُمْ بِمَا كُنتُمْ تَعْمَلُونَ﴾

**“Nëse prindërit e tu të shtyjnë të më
shoqërosh diçka në adhurim, për të cilën ti
nuk di asgjë, atëherë mos iu bind atyre! Por,
sillu mirë me ta në këtë botë dhe ndiqe
rrugën e atyre që kthehen tek Unë të
penduar! Pastaj tek Unë është kthimi juaj e
Unë do t’ju njoftoj për atë që keni punuar.”**
(Kurani, 31:15)



Hadith

I Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë:

*“Nuk ka bindje në mëkatim; bindja është vetëm në gjëra të lejuara.”*¹⁴

Mëdyshje

Dëshiroj të mbulohem, por prindërit s'më lejojnë(!)

Kjo është një situatë që kërkon shumë maturi dhe durim. Është e vërtetë që respekti ndaj prindërve është një nga detyrat më të larta në Islam, por ky respekt ka një kufi: ai përfundon aty ku fillon kundërshtimi i urdhrat të Allahut. Nëse prindërit na kërkojnë të lëmë një detyrim fetar siç është mbulesa, ne nuk mund t'u bindemi në atë pikë, sepse Krijuesi ka përparësi ndaj krijesës. Mirëpo, refuzimi i bindjes në këtë çështje nuk do të thotë të jesh e ashpër a e pasjellshme me ta. Përkundrazi, kjo është koha kur ti duhet të tregosh moralin

¹⁴ Buhariu (7257).



më të lartë, që ata ta kuptojnë se mbulesa nuk të largon prej tyre, por të bën edhe më të mirë.

Këshillë

Motra ime e nderuar, dije se zemrat e prindërve të tu janë në Dorë të Allahut. Shpesh, kundërshtimi i tyre vjen nga frika për ty, nga paragjykimet e rrethit ose nga mosnjohja e fesë. Mos debato me ta, por bëhu shembull i butësisë. Bindju Allahut duke vënë mbulesën, por njëkohësisht shtojë shërbimin e respektin ndaj prindërve të tu!

Kur ata të shohin se mbulesa të ka bërë më të sjellshme e më të qetë, zemrat e tyre do të zbuten, me lejen e Allahut. Prandaj, qëndro besnike ndaj Zotit tënd dhe lute Atë të t'i rregullojë raportet me prindërit e tu! Shpëtimi vjen nga bindja ndaj Krijuesit e jo nga thyerja e urdhrave të Tij për të kënaqur dikë tjetër.



Mos ki frikë nga njerëzit

Ajet

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿...فَلَا تَخْشَوُا النَّاسَ وَاحْشَوْنَ...﴾

“Mos kini frikë nga njerëzit, por kini fikë nga Unë!” (Kurani, 5:44)

Hadith

I Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë:

*“Sa më e madhe të jetë sprova, aq më i madh është shpërblimi. Allahu, kur i do disa njerëz, i sprovon.”*¹⁵

Mëdyshje

Burri nuk më lejon të mbulothem (!)

Kjo është një provë e rëndë dhe e ndjeshme, sepse prek dy çështje të mëdha njëherësh:

¹⁵ Tirmidhiu (2396) dhe Ibn Maxhe (4031). Albani e konsideron hadith hasen.



bindjen ndaj Allahut dhe jetën bashkëshortore. Por, duhet ditur qartë një parim themelor i fesë: nuk ka bindje ndaj krijesës duke kundërshtuar Krijuesin. Askush, përfshirë edhe burrin, nuk ka të drejtë të ndalojë një detyrim që Allahu e ka urdhëruar.

Frika nga prishja e marrëdhënies, nga konflikti ose nga fjalët e burrit është njerëzore, por ajo nuk mund të bëhet shkak për të shkelur urdhrat e Zotit. Nëse Allahu të ka urdhëruar të mbulosh trupin tënd, atëherë kjo bindje vjen para çdo dëshire njerëzore. Sprova e vërtetë, në këtë rast, nuk është hixhabi, por zgjedhja se kë do ta kënaqësh më shumë: Krijuesin apo krijesën.

Këshillë

Motra ime, kjo situatë kërkon durim dhe urtësi të madhe. Mos e kthe këtë në një betejë inati, por në një dëshmi të besimit tënd. Fol



me bashkëshortin tënd me butësi, shpjegoji se hixhabi është një afrim me Allahun që do të sjellë më shumë bereqet në shtëpinë tuaj. Tregoji se, duke u mbuluar, ti bëhesh një grua edhe më besnike dhe më e përkushtuar ndaj familjes.

Ndonjëherë burrat frikësohen nga ndryshimi ose nga paragjykimet e shoqërisë, prandaj ndihmoje ta kuptojë se nderi yt është edhe nderi i tij. Megjithatë, nëse kundërshtimi vazhdon, kujto se Allahu të ka provuar sepse të do dhe dëshiron të të rrisë gradat. Mos e shit kënaqësinë e Allahut për të blerë qetësinë e rreme me njerëzit! Bëj dua që Allahu t'ia zbusë zemrën atij dhe qëndro e palëkundur në rrugën e të Gjithëfuqishmit!



Gjallëria e zemrës qëndron në bindje ndaj Allahut

Ajet

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اسْتَجِيبُوا لِلَّهِ وَلِلرَّسُولِ إِذَا دَعَاكُمْ لِمَا يُحْيِيكُمْ وَاعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ يَحُولُ بَيْنَ الْمَرْءِ وَقَلْبِهِ وَأَنَّهُ إِلَيْهِ تُحْشَرُونَ﴾

“O besimtarë! Përgjigjjuni Allahut e të Dërguarit kur ju thërret në atë që ju jep jetë, dhe dijeni se Allahu ndërhyt ndërmjet njeriut e zemrës së tij dhe vetëm tek Ai do të tuboheni të gjithë.” (Kurani, 8:24)

Hadith

I Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë:

*“Besimtari i fortë është më i mirë dhe më i dashur tek Allahu sesa besimtari i dobët, ndërkohë të dy ka të mira. Përpiqu ta bësh atë që të bën dobi, kërko ndihmë prej Allahut dhe mos u trego i pafuqishëm.”*¹⁶

¹⁶ Muslimi (6774).



Mëdyshje

Ende nuk jam e gatshme shpirtërisht të mbulohem (!)

Kjo është një nga grishjet më të shpeshta të vetvetes, që na bën të besojmë se gatishmëria është një ndjenjë magjike që duhet pritur të vijë vetvetiu. Por, në të vërtetë gatishmëria shpirtërore nuk është kusht për të filluar adhurimin, por është fryt i adhurimit. Imani nuk rritet duke pritur, por duke vepruar. Mbulesa është mjeti që të ndihmon të forcohesh shpirtërisht në rrugën drejt Allahut.

Këshillë

Motra ime e nderuar, ajeti kuranor na kujton se urdhrat e Allahut nuk janë ngarkesë, përkundrazi, ata na japin jetë. Mos e prit gatishmërinë si një ndjenjë që do të trokasë në derë, por kërkoje atë duke u hedhur në veprim. Gatishmëria shpirtërore vjen pas vendimit, jo domosdoshmërisht para tij. Kur



ti e vë mbulesën për hir të Allahut, pavarësisht hezitimit, ti tregon forcën e besimtares që Allahu e do, atë që nuk dorëzohet para pafuqisë së vullnetit.

Dije se askush nuk ka qenë plotësisht gati për çdo hap të madh në jetë, por hapi i parë drejt Allahut është ai që e sjell qetësinë. Mos lejo që ndjenja e mosgatishmërisë të të mbajë peng, sepse jeta kalon dhe zemra është në Dorën e Zotit e Ai mund ta ndryshojë atë në çast. Përgjigju thirrjes së Tij tani! Kërko ndihmë prej Tij dhe mos u trego e pafuqishme. Sapo të mbulosh kokën, do të shohësh se si Allahu do ta mbulojë zemrën tënde me një siguri që nuk mund ta gjesh kurrë duke e pritur jashtë rrugës së Tij.



Ruaje Allahun, që Ai të të ruajë ty

Ajet

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿مَنْ عَمِلَ صَالِحًا مِّن ذَكَرٍ أَوْ أُنْثَىٰ وَهُوَ مُؤْمِنٌ فَلَنُحْيِيَنَّهٗ حَيَوةً طَيِّبَةً وَلَنَجْزِيَنَّهُمْ أَجْرَهُم بِأَحْسَنِ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ﴾

“Kujtdo që bën vepra të mira, qoftë mashkull, qoftë femër, duke qenë besimtar, Ne do t'i japim jetë të mirë dhe do ta shpërblejmë sipas punëve më të mira që ka bërë.” (Kurani, 16:97)

Hadith

I Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë:

“Ruaje Allahun, që Ai të të ruajë ty! Ruaje Allahun, që ta kesh pranë! Kur të lypësh, lypi Allahut e, kur të kërkosh ndihmë, kërko nga Allahu! Gjithashtu, dije se, po qe se të gjithë njerëzit do të mblidheshin për të të bërë mirë, nuk do të mund të të bëjnë mirë, pos asaj që ta ka caktuar Allahu, dhe anasjellas, nëse



bashkohen për të të bërë dëm, nuk do të mund të të dëmtojnë, përveç asaj që të ka caktuar Allahu.”¹⁷

Mëdyshje

Mbulesa më vë pengesa në jetë (!)

Kjo mëdyshje vjen nga mendimi se liria dhe suksesi varen nga përshtatja me standardet e njerëzve. Shpesh mendojmë se mbulesa do të na mbyllë dyer, do të na kufizojë mundësitë ose do të na e vështirësojë përditshmërinë. Mirëpo, ne harrojmë se çelësat e çdo dere janë në Dorën e Allahut. Ajo që ne e shohim si pengesë, në të vërtetë, nga këndvështrimi i besimit është një mbrojtje dhe një rrugë e sigurt drejt një jete me kuptim. Pengesa e vërtetë në jetë nuk është veshja që na e ka urdhëruar Krijuesi, por humbja e lidhjes me Atë që rregullon çdo çështje tonën.

¹⁷ E shënon Tirmidhiu (2516) dhe thotë se është hadith hasen-sahih.



Këshillë

Motra ime e nderuar, mos e shiko mbulesën si një mur pengues, por si një dritë që të orienton. Allahu premton jetë të mirë për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, ndërkohë mbulesa është një nga ato vepra që e tërheqin këtë bekim. Kur ti i ruan kufijtë e Allahut përmes hixhabit, Allahu premton se do të të ruajë në çdo hap.

Nëse dikush të thotë se mbulesa të pengon, kujtoji vetes se asnjë e mirë nuk mund të të vijë nga njerëzit, nëse Allahu nuk e ka caktuar, dhe asnjë dëm nuk mund të të prekë, nëse Ai të merr nën mbrojtjen e Tij. Mbulesa nuk të pengon të jesh e suksesshme ose e dobishme, ajo thjesht të jep dinjitetin që të mos jesh skllave e imazhit të jashtëm. Mbështetu në Allahun, se, kur Ai të ka pranë, çdo vështirësi kthehet në lehtësi dhe çdo "pengesë" bëhet një dëshmi e dashurisë sate për Krijuesin.



Bindja ndaj Zotit është nder, jo barrë

Ajet

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿وَالَّذِينَ جَاهَدُوا فِينَا لَنَهْدِيَنَّهُمْ سُبُلَنَا وَإِنَّ اللَّهَ لَمَعَ الْمُحْسِنِينَ﴾

“Ndërkaq, ata që bëjnë përpjekje për Ne, do t'i udhëzojmë në rrugët Tona. Me të vërtetë, Allahu është me punëmirët.” (Kurani, 29:69)

Hadith

I Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë:

“Unë i kam shpallur luftë atij që armiqëson ndonjë mik Timin. Gjërat më të dashura tek Unë e me të cilat më afrohet robi janë ato që ia kam obliguar. Ai vazhdon të më afrohet me vepra vullnetare derisa ta dua, e, kur ta dua, i bëhem dëgjimi me të cilin dëgjon, shikimi me të cilin sheh, dora me të cilën prek dhe këmba



me të cilën ecën. Nëse më kërkon diçka, ia jap dhe, nëse më kërkon mbrojtje, e mbroj.”¹⁸

Mëdyshje

Është e vështirë t'i rri gati gjithmonë mbulesës (!)

Në të vërtetë, mbulesa nuk është e rëndë për atë që e ka kuptuar se Kujt po i bindet. Ajo nuk është barrë, por pjesë e bindjes ndaj Allahut, ashtu si namazi, agjërimi ose largimi nga haramet. Ajo bëhet e vështirë vetëm atëherë kur shihet si imponim shoqëror, si zakon ose si diçka e huaj për zemrën. Kur njeriu bën një vepër për hir të Allahut, ajo nuk e rëndon, por përkundrazi, e qetëson. Vështirësia nuk qëndron te mbulesa, por te konflikti mes bindjes ndaj Allahut dhe presionit të njerëzve.

¹⁸ Buhariu (6502).



Këshillë

Motër e nderuar, mbulesa nuk është një barrë e rëndë mbi supe, por një zgjedhje e ndershme e zemrës besimtare. Kur ajo vendoset për Allahun, bëhet e lehtë dhe e natyrshme.

Mos e shih mbulesën si diçka që kërkon forcë të jashtëzakonshme. Ajo është thjesht bindje ndaj Krijuesit, e, çdo bindje ndaj Tij është e lehtë për atë zemër që e do Allahun. Prandaj, mos thuaj: “Është e vështirë”, por thuaj: “Është urdhër i Zotit tim dhe bindja ndaj Tij është nder e krenari!”



Fillo nga vetja

Ajet

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿أَتَأْمُرُونَ النَّاسَ بِالْبِرِّ وَتَنْسَوْنَ أَنْفُسَكُمْ وَأَنْتُمْ تَتْلُونَ الْكِتَابَ أَفَلَا تَعْقِلُونَ﴾

“Vallë, si i urdhëroni njerëzit të bëjnë mirë, kurse veten e harroni, ndërkohë që ju e lexoni Librin?! A nuk mendoni?!” (Kurani, 2:44)

Hadith

I Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë:

*“Shembulli i atij që ua mëson njerëzve të mirën, por e harron veten, është si shembulli i kandilit: u jep dritë të tjerëve, ndërsa digjet vetë.”*¹⁹

¹⁹ Taberaniu në "El-Mu'xhem el-Kebir" (1681) dhe Ibn Ebi Asim në "El-Ahad uel-Methani" (2314). Albani e ka vlerësuar si sahih në "Sahihul Xhami'i" (5831).



Mëdyshje

Si e pambuluar mund të ndikoj më shumë në përmirësimin e shoqërisë (!)

Ky është një nga shfajësimet më të rrezikshme që njeriu ia paraqet vetes për t'iu shmangur përgjegjësisë. Mendimi se njerëzit të dëgjojnë më shumë kur nuk ke shami ose se ashtu dukesh më e hapur dhe ndikon më shumë te të tjerët që të afrohen me fenë është mashtrim i shejtanit.

Askush nuk mund t'i udhëheqë të tjerët drejt Allahut duke kundërshtuar vetë urdhrat e Tij. Thirrja drejt së mirës nuk ndërtohet mbi mosbindje. Nëse për të pasur ndikim duhet të sakrifikosh hixhabin, atëherë nuk po thërret drejt fesë së Allahut, por drejt një versioni të fesë që i përshtatet frikës dhe justifikimeve njerëzore.

Shoqëria nuk ka nevojë për modele që bëjnë kompromis me parimet, por për njerëz që e



ndjekin fenë me vepër, para se ta shpallin me fjalë.

Këshillë

Motra ime, mos u bëj kandili që u jep dritë të tjerëve, ndërsa vetë shkrumbohët. Çfarë vlere ka nëse njerëzit përmirësohen nga fjalët e tua, ndërkohë që ti mbetesh jashtë bindjes ndaj Krijuesit?!

Allahu na e ka bërë të qartë se ne e njohim të vërtetën brenda vetes, pavarësisht sa bukur i paketojmë shfajësimet tona. Ndikimi i vërtetë nuk vjen nga përshtatja me shoqërinë, por nga bereqeti i bindjes.

Kur ti mbulohesh, fjala jote fiton peshë, sepse nuk flet më vetëm me gjuhë, por edhe me vepër. Mos u bëj dëshmitare kundër vetvetes në Ditën e Gjykimit! Mos prano të jesh thjesht një urë ku të tjerët kalojnë drejt Xhenetit, ndërsa ti mbetesh pas!



Përmirësimi i shoqërisë fillon me dorëzimin
tënd të plotë ndaj Allahut. Vetëm atëherë
drita jote do të jetë shkak për udhëzimin e të
tjerëve dhe shpëtim për ty!



Nxito drejt faljes dhe Xhenetit

Ajet

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿وَأَطِيعُوا اللَّهَ وَالرَّسُولَ لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ﴾ (١٣٢) وَسَارِعُوا إِلَىٰ مَغْفِرَةٍ مِّن رَّبِّكُمْ
وَجَنَّةٍ عَرْضُهَا السَّمَاوَاتُ وَالْأَرْضُ أُعِدَّتْ لِلْمُتَّقِينَ ﴿١٣٣﴾

“Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit, që të mëshiroheni! Nxitoni drejt faljes nga Zoti juaj dhe (drejt) Xhenetit, gjerësia e të cilit është sa qiejt e Toka, i cili është përgatitur për të devotshmit!” (Kurani, 3:132-133)

Hadith

I Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë:

“Shfrytëzo pesë gjëra para se të vijnë pesë të tjera: rininë para pleqërisë, shëndetin para sëmundjes, pasurinë para varfërisë, kohën e lirë para angazhimit dhe jetën para vdekjes!”²⁰

²⁰ Hakimi (7846).



Mëdyshje

Jam ende e re, do të mbulothem më vonë (!)

Ky mendim është një nga mashtrimet më të rrezikshme të shejtanit, që na bën të besojmë se kemi kohë të mjaftueshme për t'u përmirësuar më vonë. Të mendosh se mbulesa i takon vetëm pleqërisë, do të thotë ta trajtosh fenë si një përgatitje për varrin, duke harruar se ajo në të vërtetë është nuri që i jep kuptim e hijeshi jetës sate. Askush nuk ka një kontratë me jetën që i garanton se do ta arrijë pleqërinë. Rinia është koha kur adhurimi ka vlerën më të madhe tek Allahu, sepse është koha e energjisë dhe e forcës së vullnetit.

Këshillë

Motra ime e nderuar, çdo vonesë në bindjen ndaj Allahut është humbje kohe që nuk kthehet. Rinia kalon shpejt dhe askush nuk e di sa prej saj do t'i mbetet. Sot ke fuqi, vullnet



e mundësi; nesër mund të kesh vetëm kujtim e pendim.

Mbulesa është vendim që e vendos drejtimin e jetës. Kur e zgjedh herët, ajo të mbron nga lëkundjet, të qartëson qëllimin dhe ta ruan zemrën. Sa më shumë që shtyhet bindja, aq më shumë rrënjosen zakonet dhe aq më i vështirë bëhet kthimi. Mos e llogarit besimin me premtime për të ardhmen. Ajo që sot e shtyn bindjen, nuk ka garanci se nesër do ta ketë atë. Jepi Allahut sot atë që ke sot, sepse bindja e hershme është themel i fortë për një jetë të qëndrueshme dhe për një përfundim të mirë!



Lum të huajt!

Ajet

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿وَلَا تَحْزَنُوا وَلَا تَحْزَنُوا وَأَنْتُمْ الْأَعْلَوْنَ إِنْ كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ﴾

“Mos u dobësoni e mos u pikëlloni, sepse ju jeni më të lartët, nëse jeni besimtarë!”
(Kurani, 3:139)

Hadith

I Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë:

“Islami ka filluar si i huaj dhe do të kthehet si i huaj, ashtu siç ka filluar, andaj lum këta të huaj!”²¹

²¹ Muslimi (372).



Mëdyshje

Nëse mbulothem, do të izolothem nga shoqëria (!)

Kjo frikë shpesh buron nga dëshira jonë e natyrshme për t'u ndier të pranueshëm në shoqëri. Mendojmë se mbulesa do të na krijojë distancë me njerëzit, do të na largojë nga shoqëria ose do të na bëjë të dukemi të huaj në sytë e të tjerëve. Por, pyetja e vërtetë është: cilën shoqëri po e kërkojmë?

Atë që na pranon vetëm nëse i përshtatemi apo kënaqësinë e Krijuesit që na ka nderuar me udhëzim? Izolimi i vërtetë nuk është të jesh e huaj për njerëzit, por të jesh e huaj për parimet e tua dhe për bindjen ndaj Allahut.

Këshillë

Motra ime e nderuar, mos e shih mbulesën si mjet izolimi, por si një kriter që ndan të përkohshmen nga e vërteta. Ajo largon nga jeta jote ata që të vlerësonin vetëm për pamjen





tënde dhe të afron me njerëz që të respektojnë për besimin tënd dhe për parimet e tua.

Prandaj, mos u dobëso e mos u pikëllo, sepse vlera jote nuk matet me numrin e njerëzve përreth, por me afërsinë që ke me Zotin tënd. Të jesh e huaj në mesin e njerëzve për hir të Allahut është një gradë e lartë, të cilën i Dërguari (ﷺ) e ka përgëzuar me lumturi.

Kur vendos mbulesën, ti bëhesh pjesë e një rrethi më fisnik: rrethit të besimtarëve të sigurtë dhe miqve të Allahut. Mos u përpiq të përshtatesh me një botë kalimtare duke rrezikuar vendin tënd në botën e amshuar. Buzëqesh, sepse të qenët e huaj për hir të Allahut është nder i madh dhe shenjë e besnikërisë sate ndaj Tij!



Xheneti nuk fitohet pa flijim

Ajet

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿أَحْسِبِ النَّاسَ أَنْ يَبْرُكُوا أَنْ يَقُولُوا ءَامَنَّا وَهُمْ لَا يُفْتَنُونَ﴾

**“A mendojnë njerëzit se do të lihen të thonë:
"Besuam" pa u sprovuar?!” (Kurani, 29:2)**

Hadith

I Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë:

*“Vërtet, malli i Allahut është i shtrenjtë!
Vërtet, malli i Allahut është Xheneti.”²²*

Mëdyshje

Nëse mbulohem, më duhet të flijoj shumëçka (!)

Është e natyrshme të mendosh kështu.
Ndonjëherë të duket sikur mbulesa do të të marrë diçka: rehatinë, stilin e jetës me të cilin

²² Tirmidhiu (2450).



ishe mësuar ose ndonjë miqësi. Kjo ndjenjë lind kur shikimi ynë ndalet tek ajo që po lëmë pas dhe harron atë që po fitojmë.

Por çdo zgjedhje në jetë ka një çmim. Pyetja nuk është nëse do të flijosh, por për kë dhe për çfarë po flijon. Ajo që lihet për hir të Allahut nuk humbet, përkundrazi, merr vlerë. Prova që shoqëron këtë vendim nuk vjen për të të rënduar, por për të treguar sa e sinqertë është fjala jote “*besova*”. Kjo, se, po të ishte besimi gjithmonë i lehtë, ai nuk do ta kishte peshën dhe nderin që ka.

Këshillë

Motra ime e nderuar, asgjë e madhe në këtë botë nuk arrihet pa sakrificë. E si mund të pritet që Xheneti, malli më i shtrenjtë i Allahut, të fitohet pa flijuar asgjë nga egoja dhe dëshirat tona?!

Mbulesa mund të kërkojë prej teje të heqësh dorë nga pëlqimi i njerëzve ose nga rehatia e



përkohshme, por në këmbim ajo të jep diçka shumë më të thellë: qetësi në zemër, forcë të brendshme dhe lidhje të sinqertë me Allahun. Kur të duket se po flijon diçka, kujto se në të vërtetë ti po jep diçka të përkohshme për të fituar diçka të përhershme!

Prandaj, mos u frikëso nga çmimi i bindjes, se, sapo ta shijosh kënaqësinë e Allahut, do ta kuptosh se gjithçka që ke lënë pas nuk vlen as sa një pikë uji përballë oqeanit të mirësive që Ai ka përgatitur për ty!



Përgatitu për të nesërmen

Ajet

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَلْتَنظُرْ نَفْسٌ مَّا قَدَّمَتْ لِإِعَادٍ وَاتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ خَبِيرٌ بِمَا تَعْمَلُونَ﴾

“O ju që besoni, kijen frikë Allahun dhe le të shikojë secili se çfarë ka përgatitur për të nesërmen! Frikësojuni Allahut, se me të vërtetë Allahu di mirë gjithçka që bëni!”
(Kurani, 59:18)

Hadith

I Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë:

“Paraprijuni me vepra të mira fitneve si nata e errët, në të cilat, në mëngjes njeriu është besimtar e në mbrëmje bëhet jobesimtar, ose në mbrëmje besimtar e në mëngjes jobesimtar: e shet fenë për një interes të dynjasë.”²³

²³ Muslimi (118) dhe Tirmidhiu (2195).



Mëdyshje

Do të mbulohem kur të mbaroj shkollën - studimet (!)

Shpesh e shohim shkollimin si pengesë për mbulesën, duke menduar se suksesi akademik kërkon të jemi pa ngarkesa fetare mbi krye. Ky mendim shpesh fsheh frikën se mbulesa mund të na mbyllë dyer, të na kufizojë ose të na bëjë të dukemi më pak të pranuar në mjedisin shkollor. Por, a ka kuptim të përfundojmë shkollën e kësaj bote, duke lënë pas dore “shkollën” e ahiretit?

Studimet janë për një të nesërme që askush nuk e ka të garantuar, ndërsa bindja ndaj Krijuesit është përgatitje për të nesërmen që është e sigurt për secilin prej nesh. Kur e shtyjmë bindjen, në të vërtetë nuk po zgjedhim dijen, por po e kushtëzojmë atë me frikë e pasiguri.



Këshillë

Motra ime e nderuar, diploma që po e kërkon me aq përkushtim është një mjet për jetën e kësaj bote, ndërsa hixhabi është një nga mjetet e shpëtimit për jetën tjetër. Mos e kushtëzo bindjen ndaj Allahut me përfundimin e studimeve, sepse dija e vërtetë është ajo që të afron me Zotin, jo ajo që të bën të hezitosh përballë urdhrave të Tij.

Sa shumë do të kishte bereqet në studimet e tua sikur t'i ndiqje ato duke qenë nën mbrojtjen dhe kënaqësinë e Allahut!

Bota ndryshon shpejt dhe sprovat janë si nata e errët: sot njeriu ka vullnet, nesër mund të gjendet në rrethana që ia dobësojnë zemrën. Mos e shit fenë për një interes të përkohshëm të dynjasë.

Mbulesa nuk të pengon të jesh studente e shkëlqyer, profesioniste e suksesshme ose grua e aftë. Përkundrazi, ajo tregon se ti ke një prioritet më të lartë se çdo diplomë:



kënaqësinë e Atij që të dha mendjen dhe mundësinë për të studiuar. Shfrytëzoje kohën e studimeve për t'i treguar vetes dhe botës se dija e bindja ecin dorëpërdore!



Bindja ndaj Zotit nuk lidhet me martesën

Ajet

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنَّ وَعْدَ اللَّهِ حَقٌّ فَلَا تَغُرَّنَّكُمُ الْحَيَاةُ الدُّنْيَا وَلَا يَغُرَّنَّكُم بِاللَّهِ الْغُرُورُ﴾

“O njerëz! Me të vërtetë, premtimi i Allahut është i vërtetë, andaj mos lejoni që t’ju mashtrojë jeta e kësaj bote, as mos lejoni mashtruesin (shejtanin) t’ju mashtrojë për Allahun.” (Kurani, 35:5)

Hadith

Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon:

“I Dërguari i Allahut (ﷺ) e falte namazin e sabahut, e bashkë me të, si xhemat, faleshin edhe disa gra besimtare, të mbështjella me pelerinat e tyre (që e mbulonin trupin tërësisht). Pas namazit, ktheheshin nëpër



*shtëpitë e tyre dhe askush s'kishte mundësi t'i
njihte.*²⁴

Mëdyshje

Do të mbulothem kur të martohem (!)

Kjo mëdyshje lind kur bindja shtyhet dhe lidhet me një etapë të ardhshme të jetës. Martesa shihet si koha e duhur për t'u përmirësuar dhe për t'iu bindur Allahut. Mirëpo Allahu nuk e ka kushtëzuar mbulesën me martesën, por me besimin.

Gratë besimtare në kohën e të Dërguarit (ﷺ) nuk pritën të martoheshin që të mbuloheshin. Përkundrazi, ato iu përgjigjën urdhrit sapo ai zbriti.

Martesa është e pasigurt: mund të vijë shpejt ose vonë, por mund edhe të mos vijë fare, ndërsa urdhri i Allahut është i sigurt e i

²⁴ Buhariu (372) dhe Muslimi (645).



menjëhershëm. Shtyrja e bindjes për më vonë është mashtrim i shejtanit.

Këshillë

Motra ime e nderuar, mos e kushtëzo bindjen ndaj Allahut me një ngjarje që ende nuk ka ardhur. Martesa nuk është çelësi i bindjes; shpesh është bindja ajo që hap dyert e një martese të bekuar.

Mosvënia e mbulesës sot mund të bëhet shkak që të mos të afrohet një besimtar i mirë dhe i devotshëm, ose që të lidhesh me dikë që nuk e pranon mbulesën tënde nesër. Ndërkaq, kur ti i bindesh Allahut që tani, i bën të qarta parimet e tua dhe i hap rrugë një martese të ndërtuar mbi respektin për fenë, jo mbi kompromisin me të.

Nëse nuk e gjen guximin t'i bindesh Allahut kur je vetëm, si do ta gjesh atë kur të kesh në krah një burrë që ndoshta nuk të mbështet? Ndërtoje veten përpara se të ndërtosh familje!



Para Allahut do të japësh llogari e vetme

Ajet

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ وَأَحْشَوْا يَوْمًا لَا يَجْزِي وَالِدٌ عَنْ وَلَدِهِ وَلَا مَوْلُودٌ هُوَ جَازٍ عَنْ وَالِدِهِ شَيْئًا إِنَّ وَعْدَ اللَّهِ حَقٌّ فَلَا تَغُرَّنَّكُمُ الْحَيَاةُ الدُّنْيَا وَلَا يَغُرَّنَّكُم بِاللَّهِ الْغَرُورُ﴾

“O njerëz! Kijeni frikë Zotin tuaj dhe frikësojuni një Dite kur asnjë prind nuk do të mund t'i bëjë kurrfarë dobie fëmijës së vet e as fëmija nuk do të mund t'i bëjë kurrfarë dobie prindit të vet. Premtimi i Allahut është i vërtetë, andaj mos lejoni që t'ju mashtrojë jeta e kësaj bote, as mos lejoni mashtruesin (shejtanin) t'ju mashtrojë për Allahun.” (Kurani, 31:33)



Hadith

I Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë:

“Allahu do t'i flasë secilit drejtpërdrejt, pa përkthyes mes Allahut dhe robit. Kur robi shikon djathtas, nuk sheh asgjë përveç veprave të veta. Pastaj shikon majtas, sërish nuk sheh asgjë përveç veprave të veta. Pastaj shikon para vetes, por nuk sheh asgjë përveç Zjarrit përpara fytyrës. Prandaj, ruajuni nga Zjarri, qoftë dhe me gjysmë hurme.”²⁵

Mëdyshje

Do të mbulohem kur të mbulohet motra - shoqja ime (!)

Kjo mëdyshje lind kur bindja kushtëzohet me veprimin e dikujt tjetër. Por, kjo është një vetëmashtrim i rrezikshëm! Allahu nuk i ka lidhur urdhrat e Tij me gatishmërinë e motrës

²⁵Buhariu (7512) dhe Muslimi (2348).



ose shoqes sate, por me përgjegjësinë tënde personale. Në Ditën kur as prindi nuk i bën dobi fëmijës e as fëmija prindit, si mund të shpresosh se do të të vlejë justifikimi: “Prita dikë tjetër”?!

Shejtani e zbukuron këtë pritje duke ta paraqitur si shoqëri e mbështetje, por në të vërtetë kjo është vetëm shtyrje e zbatimit të urdhrit hyjnor.

Këshillë

Motra ime, mos e vono bindjen tënde duke pritur vendimin e dikujt tjetër, sepse në Ditën e Gjykimit secili do të dalë para Allahut veçmas, vetëm me veprat e veta.

Dije edhe këtë: nëse ti e hedh hapin sot dhe bëhesh shkak që motra ose shoqja jote të mbulohet, Allahu do të të japë shpërblimin e saj, pa iu pakësuar asaj aspak shpërblimi. Ndoshta ajo po të pret ty, ashtu siç po e pret ti atë. Nëse të dyja prisni, asnjëra nuk ecën



përpara. Por, nëse njëra e merr hapin konkret, mund të bëhet shkak për udhëzimin e tjetrës. Kurrë mos e lidh fatin tënd të ahiretit me hezitimin e njerëzve!



Punën e sotme mos e lër për nesër

Ajet

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿إِنَّمَا كَانَ قَوْلَ الْمُؤْمِنِينَ إِذَا دُعُوا إِلَى اللَّهِ وَرَسُولِهِ لِيَحْكُمَ بَيْنَهُمْ أَنْ يَقُولُوا سَمِعْنَا وَأَطَعْنَا وَأُولَئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ﴾

“Sa u përket besimtarëve, kur thirren tek Allahu dhe i Dërguari i Tij që të gjykojë mes tyre, ata thonë: "Dëgjojmë dhe bindemi." Këta janë të shpëtuarit.” (Kurani, 24:51)

Hadith

I Dërguari i Allahut (ﷺ) lutej me fjalët:

“O Allah, kërkoj mbrojtjen Tënde nga humbja e begative të Tua, nga largimi i shëndetit që ma ke dhënë, nga zemërimi Yt i befasishëm dhe nga gjithë hidhërimi Yt!”²⁶

²⁶ Muslimi (2739).



Mëdyshje

Do të mbulohem së shpejti (!)

Kjo fjali tingëllon si vendim, por në të vërtetë është shtyrje. “Së shpejti” nuk është kohë, por një premtim i paqartë që njeriu ia jep vetes për të qetësuar ndërgjegjen. Besimtari i vërtetë, kur e kupton urdhrin e Allahut, nuk e shtyn zbatimin e tij për një kohë më të përshtatshme, sepse bindja lidhet me gatishmërinë e zemrës e jo me rrethanat.

Kur Allahu thërret, përgjigjja e besimtarëve nuk është “më vonë”, por “dëgjuam dhe u bindëm”. Çdo shtyrje e qëllimshme është humbje e një rasti, sepse askush nuk e ka të garantuar as shëndetin, as jetën e as mundësinë e nesërme. Shejtani nuk e ndalon njeriun hapur nga bindja, ai thjesht i thotë: “Lëre për më vonë.”



Këshillë

Motra ime, mos e kthe bindjen në një plan të paafat. Hixhabi nuk ka nevojë për “kohën e duhur”, por për zemrën e vendosur. Përderisa je e bindur se ky është urdhër i Allahut, atëherë sot është koha më e mirë për ta zbatuar atë.

I Dërguari (ﷺ) kërkonte mbrojtje nga humbja e begative dhe nga largimi i shëndetit, sepse këto ndodhin papritur. Sa e sa vendime të mira janë shtyrë me “së shpejti” dhe nuk janë realizuar kurrë!

Mos e lër punën e sotme për nesër, sepse nesër mund të mos jesh ti, mund të mos jetë fuqia, ose mund të mos jetë më ajo ndjeshmëri që sot ta ka zbutur zemrën! Bëje hapin tani, sepse bindja e menjëhershme është shenjë e sinqeritetit dhe Allahu i do ata që i përgjigjen thirrjes së Tij pa vonesë.



A nuk ka ardhur koha?!

Ajet

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿أَلَمْ يَأْنِ لِلَّذِينَ ءَامَنُوا أَنْ تَخْشَعَ قُلُوبُهُمْ لِذِكْرِ اللَّهِ وَمَا نَزَلَ مِنَ الْحَقِّ﴾

“A nuk ka ardhur koha për ata që besuan, që zemrat e tyre të përulen para përmendjes së Allahut dhe para së vërtetës që ka zbritur...?!” (Kurani, 57:16)

Hadith

I Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë:

“Allahu i Lartësuar ka thënë: “Unë, për robin Tim, jam ashtu siç ai mendon për Mua dhe jam me të kur ai më kujton.” – Beto hem në Allahun se Allahu gëzohet për pendimin e robit të Vet më shumë se një person që e gjen devenë e humbur në shkretëtirë. – “Atij që më afrohet sa një pëllëmbë, Unë i afrohem sa një kut, atij që më afrohet sa një kut, Unë i afrohem sa një



*pash. Kur më vjen duke ecur, Unë i shkoj duke
nxituar.””²⁷*

Mëdyshje

Si të mbulohem pas kaq vitevsh (!)

Ndonjëherë pesha e viteve pa mbulesë e bën zemrën të ndiejë turp dhe pasiguri. Mendimet vijnë njëri pas tjetrit: “Çfarë do të thonë njerëzit që më kanë parë gjithë jetën pa shami?” ose: “A do të më pranohet kjo vepër tani, pas gjithë këtyre viteve?”

Ky është një nga kurthet më të holla e më djallëzore të shejtanit: të të mbajë peng të së kaluarës. Ai të pëshpërit se “koha jote ka kaluar”, që të të pengojë të shpëtosh të ardhmen. Por, nëse i kthehesh Allahut sinqerisht, Ai t’i fal gjynahet e kaluara dhe ta përmirëson të ardhmen.

²⁷ Muslimi (6952).



Këshillë

Motra ime e nderuar, kurrë nuk është vonë për t'u bërë ajo që Allahu dëshiron të jesh. Nëse zemra jote rreh më fort kur dëgjon ajetin “*A nuk ka ardhur koha?*”, kjo është shenja më e qartë se Allahu po të thërret pranë Vetes.

Mos e mat veten me shikimet e njerëzve që të kanë njohur ndryshe, por me mëshirën e Atij që po të pret me gëzim. Allahu gëzohet për kthimin tënd më shumë se ai udhëtari që gjen shpëtimin në mes të shkretëtirës, pasi kishte humbur të gjitha shpresat për jetë.

Sapo ta vendosësh hixhabin, ai veprim fshin peshën e ngurrimit të kaluar dhe hap një faqe të re e të pastër. Mos lejo që e nesërmja të bëhet edhe një “dje” tjetër e humbur! Nëse Allahu të dha frymë edhe sot, do të thotë se të dha edhe mundësinë për t'u mbuluar sot.



Hidhe hapin

Ajet

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ قُلْ لِّأَزْوَاجِكَ وَبَنَاتِكَ وَنِسَاءِ الْمُؤْمِنِينَ يُدْنِينَ عَلَيْهِنَّ مِنْ جَلَابِيبِهِنَّ ذَلِكَ أَدْنَى أَنْ يُعْرَفْنَ فَلَا يُؤْذَيْنَ وَكَانَ اللَّهُ عَفُورًا رَحِيمًا﴾

“O Profet, thuaju grave e bijave të tua dhe grave të besimtarëve që t'i lëshojnë mbulesat (*xhilbabet*) mbi trupat e tyre. Kështu është më afër që ato të njihen (si gra të dëlira) e të mos ngacmohen. Allahu është Falës i Madh e Mëshirëplotë.” (Kurani, 33:59)

Hadith

Ummu Selemja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon:

“Kur zbriti ajeti: “... le t'i lëshojnë mbulesat mbi trupat e tyre”, gratë e ensarëve dolën nga shtëpitë e tyre, aq sa dukej sikur mbi kokat e



tyre kishin korba, për shkak të rrobave që mbanin.”²⁸

Mëdyshje

E dua mbulesën, por nga ndrojtja ngurroj të mbulohem (!)

Ndrojtja shpesh tregon se ti e çmon lart këtë hap dhe e ndien peshën e tij në zemër. Por, ajo ndonjëherë kthehet në pengesë, sepse të duket sikur për një çast do të jesh në qendër të vëmendjes dhe shikimet e njerëzve do të rëndojnë mbi ty. Ky ngurrim nuk vjen nga mungesa e bindjes, por nga frika e reagimit të të tjerëve.

Duhet ta dish se kjo ndrojtje është e përkohshme, ndërsa qetësia që vjen nga bindja ndaj Allahut është e qëndrueshme. Njerëzit shohin për pak çaste, flasin për pak ditë dhe harrojnë shpejt, ndërsa Allahu sheh

²⁸ Albani, “Sahih Ebi Davud” (4101).



gjithmonë. Nuk ka pse të kesh turp të shfaqësh bindjen tënde ndaj Zotit; turpi i vërtetë është të vonosh një vepër që zemra jote e di se është e drejtë, vetëm nga frika e mendimit të njerëzve.

Këshillë

Motra ime e nderuar, ajo që sot e quan ngurrim është shenjë se zemra jote është gati, por pret guximin e hapit të parë.

Gratë e para besimtare nuk e shihnin mbulesën si barrë a si diçka për t'u justifikuar, por si pjesë të natyrshme të bindjes së tyre ndaj Zotit. Ato ecnin të mbështjella, të qeta dhe të sigurt, të padukshme për shikimet e liga, por të njohura në qiell.

Mos lejo që fjalja “*çfarë do të thonë njerëzit*” të peshojë më shumë se “*çfarë ka urdhëruar Allahu*”. Sapo ta hedhësh hapin, do të shohësh se ajo ndrojtje do të tretet dhe do të zëvendësohet me një ndjenjë qetësie e



vetërespekti, meqë ti po e vë mbulesën për të
fituar kënaqësinë e Zotit tënd Bujar.

Pra, hidhe hapin për Allahun, sepse Ai nuk e
lë kurrë pa përkrahje atë që zgjedh bindjen
ndaj Tij!



Këshillë përmbyllëse

Motër e nderuar, të ndjekësh fenë e Zotit në çdo kohë kërkon vendosmëri, por dije se askush nuk është penduar pse ka zbatuar urdhrat e Zotit të vet. Përkundrazi, pendimi i vërtetë është për kohën që kalon larg bindjes. Kurrë nuk do të gjesh një besimtar të sinqertë që është penduar pse ka filluar të falet. Edhe sikur t'i ofroheshin miliona euro për ta lënë, qoftë dhe një namaz të vetëm, ai nuk do të pranonte, sepse e di se namazi vlen më shumë se gjithë pasuria e kësaj bote.

Kjo vlen edhe për mbulesën. Besimtarja që e ka kuptuar vlerën e saj nuk e shet bindjen ndaj Allahut për asnjë çmim. Ajo e di se çdo gjë në këtë botë është e përkohshme, ndërsa shpërblimi i botës tjetër është i përhershëm.

Allahu e ka krijuar njeriun që ta adhurojë vetëm Atë. Nëse i japim përparësi kësaj bote kalimtare dhe harrojmë botën e amshuar,



pendimi do të jetë i rëndë kur të dalim para Allahut. Por, nëse i japim përparësi bindjes ndaj Allahut mbi çdo gjë tjetër, atëherë fitojmë shpërblimin që nuk mbaron kurrë.

Dëgjo çfarë thotë Allahu i Madhërishëm:

﴿فَأَمَّا مَنْ طَغَىٰ (٣٧) وَءَاثَرَ الْحَيَاةَ الدُّنْيَا (٣٨) فَإِنَّ الْجَحِيمَ هِيَ الْمَأْوَىٰ (٣٩) وَأَمَّا مَنْ خَافَ مَقَامَ رَبِّهِ وَهَى النَّفْسَ عَنِ الْهَوَىٰ (٤٠) فَإِنَّ الْجَنَّةَ هِيَ الْمَأْوَىٰ (٤١)﴾

“Sa për atë që ka kaluar kufijtë dhe i ka dhënë përparësi jetës së kësaj bote, atëherë, vërtet, Xhehenemi do të jetë streha e tij. Ndërsa ai që i është frikësuar qëndrimit para Zotit të vet dhe e ka ndaluar veten nga dëshirat e ulëta, atëherë, vërtet, Xheneti do të jetë streha e tij.” (Kurani, 79:37-41)

A ka tregti më të mirë se kjo: të lësh diçka kalimtare dhe të fitosh shpërblimin e përjetshëm?

Për Zotin, për asnjë arsye nuk ia vlen të vonosh bindjen ndaj Krijuesit tënd!



Prandaj, motra ime, vëre mbulesën që tani për hir të Zotit tënd dhe mos e shtyj për asnjë çast këtë vendim të rëndësishëm! Çdo hap që merret për hir të Allahut është fitore, edhe nëse në fillim duket i vështirë. Besimtarja që i përgjigjet urdhrit të Zotit të saj fiton nder në këtë botë dhe shpërblim madhështor në botën tjetër.

O Allah, na e shfaq të vërtetën si të vërtetë e na e mundëso ta ndjekim atë, si dhe të gabuarën si të gabuar e na e mundëso të largohemi prej saj! Amin!

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

28-42:396

Kastrati, Jusuf

Për ty, motër: përgjigje ndaj mëdyshjeve
lidhur me hixhabin / Jusuf Kastrati. - Prishtinë:
Instituti Germa, 2026. - 106 f.; 18 cm.

ISBN 978-9951-9279-1-8